



Funded by  
the European Union

## TERMAT E REFERENCËS

<b>Emri i projektit</b>	“Ngritja e mirëqenies së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre, si reagim ndaj ndikimit të COVID-19”- Projekt i implementuar nga HANDIKOS në partneritet me Save the Children.
<b>Lloji i angazhimit</b>	Menaxher i projektit
<b>Lokacioni</b>	Prishtinë
<b>Orari i punës</b>	Orar jo i plotë (50%)
<b>Kohëzgjatja</b>	Qershor – Dhjetor 2022
<b>Data e pritshme e fillimit</b>	Qershor, 2022
<b>Raporton tek</b>	Drejtori i organizatës

### 1. HYRJE

Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së Fëmijëve të Kosovës (tani e tutje HANDIKOS), është organizatë jo-qeveritare e zhvillimit shoqëror, e themeluar në vitin 1983, duke synuar arritjen e njohjes dhe pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara (PAK) në shoqëri. HANDIKOS mbron në mënyrë aktive në nivel lokal dhe qendror të drejtat e PAK, duke synuar krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës përmes rritjes së mundësive të punësimit; përmirësimin e qasjes në edukim, mirëqenie sociale dhe skemave të mbrojtjes sociale; dhe përmirësimin e qasjes fizike.

#### 1.1 KONTEKSTI I PROGRAMIT

HANDIKOS në partneritet me Save the Children është duke implementuar projektin “Ngritja e mirëqenies së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre, si reagim ndaj ndikimit të COVID-19”, i cili financohet nga Bashkimi Evropian. Përmes këtij projekti HANDIKOS synon të mbështesë zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe lehtësimin e pasojave të COVID-19 në mirëqenien e tyre dhe familjes përmes shërbimeve multidiciplinare të qëndrimit ditë dhe bashkëpunimit ndërsektorial.

Për të arritur rezultatet e parashikuara në lidhje me mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara; prindërve dhe kujdestarëve dhe fuqizimit të bashkëpunimit ndërsektorial në ofrimin e shërbimeve, HANDIKOS, është në kërkim të punësimit të një Menaxheri të projektit me orar të jo të plotë pune (50%).

### 2. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME E POZITËS

Menaxheri i projektit do të jetë përgjegjës për koordinimin e projektit dhe aktivitetëve/shërbimeve të tij, duke përfshirë monitorimin, vlerësimin dhe raportimin. Ajo/ai do të jetë urë-lidhëse ndërmjet menaxhmentit të HANDIKOS dhe donatorit të projektit, dhe do të sigurojë që fushëveprimi i projektit të



Save the Children





Funded by  
the European Union

jetë i qëndrueshëm, të raportohet rregullisht lidhur me progresin e projektit, dhe të sigurojë që aktivitetet do të realizohen sipas planit të miratuar. Përveç kësaj, Menaxheri i projektit do të jetë përgjegjës për koordinimin e shërbimeve sociale që u ofrohen fëmijëve me aftësi të kufizuara nga ekipi i projektit, si dhe zbatimin e aktiviteteve me të cilat synohet të promovohet dhe fuqizohet bashkëpunimi ndër-sektorial në ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara.

## 2.1 DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Koordinon aktivitetet dhe shërbimet e projektit, si dhe zbatimin e aktiviteteve të caktuara dhe zhvillimin e planeve dhe ndërhyrjeve;
- Funkcionon si urëlidhës ndërmjet menaxhmentit të HANDIKOS, donatorit dhe ekipit të projektit;
- Bashkëpunon me institucionet relevante për të siguruar arritjen e rezultateve të projekti;
- Monitoron dhe mbikëqyrë punën e ekipit të projektit;
- Siguron që projekti t'i arrijë synimet e veta siç parashihet me objektivat e përgjithshme dhe specifike, dhe me treguesit e rezultateve;
- Mbikëqyr zbatimin e përgjithshëm të projektit, duke përfshirë mbarëvajtjen e aktiviteteve sipas planit të miratuar; targeteve të paracaktuara dhe buxhetit që e shoqërojnë;
- Përgatit dhe e përditëson planin e punës, raportet mujore, tremujore dhe vjetore, në bashkëpunim me menaxhmentin e organizatës, dhe siguron raportimin me kohë tek donatori;
- Siguron që të dhënat zyrtare dhe dokumentet, si dhe dokumentet e projektit dhe zbatimi janë në përputhje dhe në harmoni me rregullat dhe udhëzimet e BE-së, legjislacionin vendor dhe praktikat më të mira ndërkombëtare;
- Merr pjesë në takimet dhe punëtoritë dhe në aktivitetet tjera sipas nevojës.

## 2.2 NJOHURITË & PËRVOJA:

- Diplomë universiteti në fushat relevante me ofrimin e shërbimeve sociale;
- Të paktën 3 vite përvojë paraprake pune në pozita të ngjashme në organizata të shoqërisë civile, veçanërisht në organizata që merren me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut;
- Përvojë të dëshmuar në zbatim të ciklit të projektit, monitorim dhe vlerësim në sektorin përkatës;
- Shkathtësi të mira menaxhimi, duke përfshirë aftësinë për të ofruar udhëzime strategjike, mbikëqyrje teknike, aftësi për të krijuar ekupe të mira, ta mentoroj stafin dhe t'i zhvillojë planet e punës;
- Përvojë punës me projektet e financuara nga BE-ja apo donator të tjerë ndërkombëtarë;
- Njohuri të mira për sa i përket kërkesave të donatorit lidhur me projektin, duke përfshirë raportimin dhe vizibilitetin;
- Aftësi të mira në hartimin e raporteve me njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze dhe shqipe në të shkruar dhe në të folur;
- Shkathtësi në prezantime, komunikim, aftësi ndër-personale dhe pune në ekip;
- Qasje pozitive në zgjidhjen e problemeve;
- Aftësi për të punuar nën tryzni dhe për t'i respektuar afatet kohore;

## 2.3 DOKUMENTET PËR APLIKIM:

- Curriculum Vitae (CV);
- Letër e motivimit që argumenton përshtatshmërinë e kandidatit me pozitën e hapur;
- Të paktën dy referenca nga punëdhënësit/bashkëpunëtorët e mëparshëm;
- Kopjen e diplomës së nivelit më të lartë të edukimit;
- Çertifikatën që dëshmon se kandidati nuk është nën hetime (në rast të përzgjedhjes)



Save the Children





Funded by  
the European Union

*Kandidatët e interesuar ftohen të dorëzojnë CV-në, letrën e motivimit, kopjen e diplomës; dhe referencat në: [handikos@handi-kos.org](mailto:handikos@handi-kos.org)*

*Ju lutemi që ta cekni në titull: “Menaxher i projektit”*

*Do të kontaktohen vetëm kandidatët që hyjnë në listën e ngushtë.  
Afati për aplikim: 1 Qershor, 2022, deri në orën 23:59.*

*HANDIKOS është i përkushtuar për barazi gjinore dhe diversitet, dhe të ketë një ekip që përbëhet nga shkathtësi, përvoja dhe aftësi të ndryshme. Ne e inkurajojmë aplikimin e kandidatëve me prejardhje të ndryshme, dhe nga komunitetet dhe sektorët e ndryshëm.*

**Për informata shtesë lidhur me HANDIKOS, shih: [www.handi-kos.org](http://www.handi-kos.org)**



**Save the Children**

